

Emri i Lëndës : Kriminalistikë							
Kodi	Tipi	Semestri	Leksione (orë/javë)	Seminare (orë/javë)	Lab (orë/javë)	Kredite	ECTS
LAW 533	C	Vjeshtë	4.00	0.00	0.00	4.00	6.00
Lektori		Nertil Bërdufi, PhD					
Asistenti		Surja Shehi, Msc					
Gjuha e kursit		Shqip					
Niveli i lëndës		Master					
Përshkrimi		Kriminalistika është shkencë e studimit të gjurmëve të krimit në vendin e ngjarjes dhe e ekzaminimit të tyre në laborator, me qëllim zbulimin dhe identifikimin e autoreve të tyre. Kjo lëndë do të japë njohuri studentëve mbi qyrrjen e vendit të ngjarje, që kryhet nga ekspertet me kualifikim të përgjithshëm kriminalistik, të inkuadruar në strukturat policore të rretheve dhe ekspertimin kriminalistik, që kryhet nga eksperte të specializuar të profileve të ndryshme (kimistë, fizikantë, biologë, elektronistë, etj) në institutet kriminalistike, të cilat në disa vende quhen Institute të Policisë shkencore, e në vende të tjera institute të shkencave ligjore (forense).					
Objektivat		1. Përvetësimi i njohurive bazë në fushën e kriminalistikës, 2. Të njohë konceptet themelore dhe të bëjë dallimin midis gjurmëve dhe sendeve prova materiale në procesin e hetimit dhe të gjykimit 3. Zbulimi, Fiksimi, Marrja dhe ekzaminimi i gjurmëve dhe sendeve prova materiale. 4. Të kontribuojë në ngritjen e verisoneve të sakta dhe parandalimin e veprave kriminale.					
Konceptet Kryesore		1. Identifikimi kriminalistik 2. Teknika kriminalistike 3. Gjurmët traseologjike 4. Taktika kriminalistike 5. Këqyrja e vendit të ngjarjes 6. Metodika kriminalistike					
Programi i Lëndës							
Java	Tema						
1	Në këtë temë do të trajtohet shkencë kriminalistike dhe roli i saj: Detyra, objekti dhe sistemi i kriminalistikës. Vendi i kriminalistikës në sistemin e shkencave juridike penale. Bazat metodologjike të kriminalistikës. Parimet e kriminalistikës; Identifikimi kriminalistik: Kuptimi i identifikimit kriminalistik. Bazat shkencore të identifikimit kriminalistik shenjat identifikuese. Përkatesia grupore dhe identifikimi kriminalistik. Objektet e identifikimit kriminalistik (Fq.15-60)						
2	Në këtë temë do të trajtohet teknika kriminalistike. Njohuri të përgjithëshme mbi teknikën kriminalistike. Zbatimi i teknikës kriminalistike nga organi procedues dhe nga specialisti kriminalist. Rëndësia, zbatimi dhe disa metoda bashkohore për ekzaminimet fiziko-kimike të mikrogjurmëve. (Fq.61-94)						
3	Në këtë temë do të trajtohet fotografia kriminalistike. Rëndësia dhe llojet. Metodën kryesore (Fq.95-112)						
4	Në këtë temë do të trajtohet traseologjia. Mekanizmi i formimit të gjurmëve traseologjike dhe klasifikimi i tyre. Rregullat e përgjithshme të zbulimit, të fiksimit dhe të marrjes së gjurmëve traseologjike. Daktiloskopia, gjurmët e gishtave dhe të pëllëmbës së dorës, rëndësia e saj. Informatizimi i gjurmëve të duarve. Ndërtimi i figurës papilare, karakteristikat e përgjithshme dhe ato të veçanta. Mekanizmi i formimit të gjurmëve të duarve. Ekzaminimi i gjurmëve të duarve - identifikimi. Kartoteka daktiloskopike dhe funksionet e saj. (Fq.113-151)						
5	Në këtë temë do të trajtohen gjurmët e këmbëve, gjurmët e veglave të thyerjes dhe gjurmët e automjeteve. Rëndësia kriminalistike. Zbulimi, fiksimi, përgatitja për ekzaminim dhe ekspertimi i tyre. (Fq.152-190)						
6	Në këtë temë do të trajtohet balistika kriminalistike. Llojet e armëve të zjarrit. Metodën e zbulimit, fiksimit të armëve, predhës dhe gjurmëve të tjera. Armët e ftohta pa teh. Metodën e zbulimit, fiksimit dhe ekzaminimit të armëve të ftohta. (Fq.191-228)						

7	Raste Studimore
8	Provim Gjysmëfinal
9	Në këtë temë do të trajtohet taktika e këqyrjes së vendit të ngjarjes: Kuptimi dhe detyrat e këqyrjes së vendit të ngjarjes. Përgatitja për këqyrjen e vendit të ngjarjes. Metodat taktike të këqyrjes së vendit të ngjarjes. Ngritja dhe verifikimi i versioneve hetimore në këqyrjen e vendit të ngjarjes. Mjetet teknike kriminalistike për fiksimin e rezultateve. (Fq.336-367)
10	Në këtë temë do të trajtohet metodika e hetimit të vrasjes (karakteristika kriminalistike): Detyrat e organit procedues, Kallëzimi dhe fillimi i çështjes penale, Veprimet e para hetimore, Versionet hetimore dhe verifikimi i tyre. (Fq.523-549)
11	Në këtë temë do të trajtohet metodika e hetimit të shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor (karakteristika kriminalistike): Detyrat e organit procedues, Metodika e hetimit të shkeljes së rregullave të qarkullimit kur automjeti që ka shkaktuar ngjarjen ka mbetur në vend, Veprimet e para hetimore, Versionet hetimore dhe verifikimi i tyre, Kërkimi i automjeteve të larguara nga vendi i ngjarjes. (Fq.550-565)
12	Në këtë temë do të trajtohet metodika e hetimit të krimeve në ushtrimin e detyrës: të korrupsionit (karakteristika kriminalistike): Detyrat e organit procedues, Kallëzimi dhe ndjekja penale, Veprimet e para hetimore, Versionet hetimore dhe verifikimi i tyre. (Fq.588-599)
13	Në këtë temë do të trajtohet metodika e hetimit të krimeve seksuale (karakteristika kriminalistike): Situatat kriminale të përdorimit të dhunës në krimet seksuale, Kallëzimi dhe fillimi i çështjes penale, Veprimet e para hetimore, Versionet hetimore dhe verifikimi i tyre. (Fq.618-631)
14	Në këtë temë do të trajtohet metodika e hetimit të kriminalitetit kompjuterik (Mashtrimi informatik): Karakteristika kriminalistike, Mashtrimet kompjuterike, Vjedhja e informacioneve, Dëmtimet kompjuterike, Detyrat e organit procedues dhe perspektiva e luftës kundër kriminalitetit kompjuterik. (Fq.644-648)
15	Raste Studimore
16	Provim Final
Parakushtet Studenti duhet të frekuentojë lëndën në masën minimale prej 75%.	
Literatura • Begeja, Skënder. Kriminalistika. Tiranë 2004 • Begeja, Skënder. Mandro, Ilir. Kqyrja e vendit të ngjarjes në vrasjet me armë zjarri. Tiranë: Ilir, 2002 • Ikononi, Vladimir. Metoda moderne në ekspertimin kriminalistik. Tiranë: Geer, 2006 • Mandro, Ilir. Ciraku, Agim. Metodika e hetimit të ngjarjeve automobilistike. Tiranë: Pegi, 2003 • Mandro, Ilir. Në labirinthe të balistikës kriminalistike. Tiranë: 2004 • Sallavaci.O. Identifikimi i personit në bazë të AND-së, Tiranë 2004	
Referenca të tjera • Mandro, Ilir. Identifikimi i armëve me anë të shenjave karakteristike në gëzhgojë. Revista Tribuna Juridike, Nr. 32, 2001 • Mandro, Ilir. Njohuri për kriminalistikën. Tiranë: Emal, 2011	
Rezultatet e Lëndës dhe Kompetencat	
1	Studentët do të jenë të aftë të kuptojnë dhe zbatojnë bazat metodologjike të kriminalistikës;
2	Studentët do të jenë të aftë të identifikojnë shenjat grupore dhe shenjat e veçanta të identifikimit kriminalistik;
3	Studentët do të jenë të aftë të kuptojnë dhe zbatojnë teknikat e ndryshme kriminalistike;
4	Studentët do të jenë të aftë të zbulojnë, fiksojnë dhe ekzaminojnë gjurmët dhe sendet prova materiale;
5	Studentët do të jenë të aftë të kuptojnë dhe zbatojnë taktikat e ndryshme kriminalistike;
6	Studentët do të jenë të aftë të kuptojnë dhe zbatojnë këqyrjen e vendit të ngjarjes;
7	Studentët do të jenë të aftë të kuptojnë dhe zbatojnë metodikat e ndryshme kriminalistike;

Mënyra e Vlerësimit të Lëndës			
Notat e Ndërmjetme	Sasia	Përqindja	
Gjysmë finale	1	30	
Kuize	0	0	
Projekte	0	0	
Projekte semestrale	0	0	
Punë laborator	0	0	
Pjesëmarrja në mësim	1	10	
Kontributi i notave të ndërmjetme mbi vlerësimin final			40
Kontributi i provimit final mbi vlerësimin final			60
Total			100
Ngarkesa ECTS (Në Bazë të Ngarkesës së Studentit)			
Aktivitetet	Sasia	Kohëzgjatja (orë)	Ngarkesa Totale (orë)
Kohëzgjatja e kursit (Duke përfshirë edhe javën e provimeve : 16x Orët totale të kursit)	16	4	64
Orët e studimit jashtë klase (Parapërgatitje, Praktika etj)	14	5	70
Detyra	0	0	0
Gjysmë finale	1	5	5
Provimi final	1	10	10
Të tjera	0	0	0
Ngarkesa totale e orëve			149
Ngarkesa totale e orëve / 25 (orë)			5.96
ECTS			6.00